

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6104
E enjte, 3 shtator 2020
çmimi 0.40 €

Mbi 13 mijë raste
pozitive me Covid në
Kosovë që nga fillimi i
pandemisë **FAQE 3**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", EDITA TAHIRI **FAQE 4-5**

TAKIMI I UASHINGTONIT DO TË SHËNOJË HAPA PËRPARA DREJT NJOHJES RECIPROKE

- Në delegacionin e Kosovës do të duhej të përfshiheshin edhe partitë opozitare



Ish-kryenegociatorja e Kosovës në dialogun me Serbinë, Edita Tahiri, ka bërë me dije se takimi në Uashington ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të shënojë hapa përpara drejt njohjes

reciproke. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ajo ka thënë se në këtë takim nuk mund të arrihet marrëveshja përfundimtare në mes të dy shteteve. Tahiri ka thënë se nëse

ndodh arritja e ndonjë marrëveshje ekonomike, ajo duhet të ketë kornizë të qartë politike. Në të kundërtën, sipas saj, marrëveshjet do ta cenonin shtetësinë e Kosovës

OPINION

ÇFARË FSHIHET PRAPA KËRKESËS GREKE PËR NDRYSHIMIN E TEKSTEVE NË LIBRAT E GJEOGRAFISË DHE TË HISTORISË SHOIPTARE? F. 11

Nga Jakup KRASNIQI



AKTUALE

VESELI BISEDON ME STRUKTURAT E PDK-së NË PODUJEVË PËR SITUATËN POLITIKE NË VEND F. 7

AMBASADA BRITANIKE: JEMI TË PËRKUSHTUAR PËR PARTNERITET ME KOSOVËN F. 7

MJEKËT E ORL-SË NË OKUK IA SHPËTOJNË JETËN FOSHNJËS NËNTËMUAJSHE F. 6

EKONOMI

NËNSHKRUHET MEMORANDUM I MIRËKUPITIMIT NDËRMJET KOSOVËS DHE SLLOVENISË NË FUSHËN E REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE F. 8

MUSTAFA: DO T'I PËRKRAHIM BUJOIT E VUSHTRISË F. 8

TAHIRI NË FERIZAJ: ANGAZHIMI I QEVERISË DO TË JETË NË TRI SHTYLLA KRYESORE F. 8

SPORT

KOSOVA SYNON TA NISË EDICIONIN ME FITORE F. 18

Ministri Reçica në Tiranë për të hedhur hapa drejt bashkimit të tregut të punës **FAQE 9**



Pas Shtëpisë së Bardhë, Hoti dhe Vuçiqi të hënën në Bruksel **FAQE 7**



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Gjermania gjen agent nervor Noviçok në mostrat e Navalnyt

BERLIN, 2 SHTATOR - Qeveria gjermane ka thënë se testet e kryera nga mostrat e marra prej liderit opozitar, Aleksei Navalny, kanë treguar prani të agentit nervor, Noviçok. Navalny, politikan dhe hulumtues i korrupsionit, njëherësh një prej kritikëve më të mëdhenj të presidentit rus Vladimir Putin, është sëmurë më 20 gusht gjatë një

udhëtimi me aeroplan, derisa ka qenë duke udhëtuar nga Siberia në Moskë. Aeroplani është detyruar të bëjë ulje emergjente në mënyrë që Navalny të dërgohet në spital. Pas spitalit siberian, ai më vonë është transferuar në një spital në Berlin, ku mjekët javën e kaluar kanë thënë se ka mundësi që Navalny është

helmuar. Steffen Seibert, zëdhënësi i kancelares gjermane Angela Merkel, ka thënë të mërkurën se testimet e kryera në spitalin ushtarak gjerman kanë treguar shenja "të një agjenti nervor nga grupi Noviçok". Ekipi i Navalnyt dyshon se ai është helmuar përmes një çaji që ka pirë në aeroport, përpara se të nisej drejt Moskës.



Abazoviqi: Njohja e Kosovës nga Mali i Zi, çështje e mbyllur



Podgoricë, 2 shtator - Politikani me prejardhje shqiptare, Dritan Abazović, bartës i listës i koalicionit "E zeza mbi të bardhën", ka deklaruar se do të jetë kundër, nëse në rend dite të qeverisë së ardhshme malazeze vihet tërheqja e njohjes së Kosovës. Në një intervistë për gazetën serbe "Kurir", të cilën e kanë transmetuar disa prej mediave kryesore në Serbi, Abazović ka thënë se pret që Kosova dhe Serbia në të ardhmen të arrijnë marrëveshje. "Natyrshë se do

të jemi kundër dhe mendoj se kjo pyetje as që do të vihet në rend dite, pasi që është çështje e kryer, nuk duhet kthyer në të kaluarën. Madje pres që Beogradi dhe Prishtina të gjejnë gjuhë të përbashkët në të ardhmen e afërt dhe të merren vesh me qëllim të uljes së tensioneve dhe mundësimit të procesit të pajtimit. Paqja nuk ka çmim. Të gjithë këtu e duan paqen", ka thënë Abazović. "Kusht i koalicionit tonë është një qeveri ekspertësh, në mënyrë që të na

përfaqësojnë njerëz të dinjitetshëm, ka thënë ai, duke shtuar se regjimi do të bëjë çmos, mafia do të bëjë çmos që të mos ndodhë një gjë e tillë. "Do të tentojnë të shkaktojnë incidente në të gjitha mënyrat", ka thënë ai. Në këtë intervistë ai ka shtuar se ëndërr e tij është "Mali i Zi në Bashkimin Evropian (BE)". "Mali i Zi në Bashkimin Evropian, të ketë pajtim dhe standard më të lartë jetese sesa tani. Jam i sigurt se ajo ëndërr mund të bëhet e vërtetë", ka thënë ai.

14 të dyshuar do të gjykohen për sulmin në revistën "Charlie Hebdo"

PARIS, 2 SHTATOR - Katërbëdhjetë persona do të gjykohen në Francë për sulmin vdekjeprurës në revistën satirike "Charlie Hebdo", më shumë se pesë vjet më parë. Shumica e bashkëpunësorëve të dyshuar për sulmin do të gjykohen në Paris, por tre do të gjykohen në mungesë. Ata akuzohen se kanë ndihmuar militantët islamikë që qëlluan

për vdekje 12 persona brenda dhe rreth zyrave të "Charlie Hebdo" në janar të vitit 2015. Një person tjetër i armatosur qëllon për vdekje një polic dhe sulmoi një dyqan hebre. Në total, 17 njerëz u vranë në një periudhë prej vetëm tre ditësh. Vrasjet shënuan fillimin e një vale sulmesh xhihadiste në të gjithë Francën që la më shumë se 250 njerëz të vdekur. Në ditët



pas sulmeve, miliona njerëz morën pjesë në marshime solidariteti në të gjithë Francën dhe nëpër botë me moton "Je suis Charlie" (Unë jam Çarli). Revista ka shënuar fillimin e gjyqit duke ribotuar karikaturat e diskutueshme të profetit Muhamed që nxitën protesta në disa vende myslimane. "Ne kurrë nuk do të rrëzohemi. Asnjëherë nuk do të

dorëzohemi", ka shkruar drejtori Laurent Sourisseau, në një editorial më 1 shtator. Katërbëdhjetë personat akuzohen se kanë ndihmuar në përgatitjen dhe planifikimin e vrasjeve. Gjyqi i tyre fillon të mërkurën pasi procedurat u shtynë për gati katër muaj për shkak të pandemisë së koronavirusit. Gjyqi pritet të zgjasë deri në nëntor.

Protestuesit bullgarë përleshën me policinë

Sofje, 2 shtator - Policia dhe protestuesit bullgarë janë përleshur të mërkurën derisa Parlamenti është mbledhur për ta filluar diskutimin mbi një kushtetutë të re. Demonstruesit kanë bllokuar rrugët dhe kanë organizuar tubime të përditshme në kryeqytetin Sofje dhe qytete të tjera për gati dy muaj. Ata po bëjnë presion për dorëheqjen e kryeministrit Bojko Borisov dhe kryeprokurorit Ivan Geshev në lidhje me pretendimet se ata janë të lidhur me oligarkët. Borisovi tashmë ka shkarkuar disa ministra kryesorë dhe së

fundmi ka propozuar miratimin e një kushtetute të re, por protestuesit i kanë hedhur poshtë këto masa. Mijëra demonstrues dolën në rrugët e Sofjes, duke brohoritur "dorëheqje" dhe "mafia" si dhe duke hedhur gurë, vezë dhe domate. Policia ka përdorur gaz lotsjellës dhe ka njoftuar se ka arrestuar tetë protestues, ndërsa 20 oficerë janë plagosur në përleshjet jashtë Parlamentit. Gjashtëmbëdhjetë persona, përfshirë protestuesit, janë pranuar në spital, sipas shërbimeve të urgjencës. Në një deklaratë brenda

Parlamentit, presidenti bullgar Rumen Radev, i cili ka shprehur mbështetje për kërkesat e protestuesve, u ka bërë thirrje ligjvënësve të "dalin nga kriza me dinjitet", duke hapur rrugën për zgjedhje të parakohshme. "Përfundimisht ka humbur besimi", ka thënë ai. Borisovi është në pushtet pothuajse pa ndërprerje për më shumë se një dekadë. Ai ka refuzuar të japë dorëheqje para se të përfundojë mandati i tij i tretë në mars të vitit të ardhshëm. Debati në Parlament për një kushtetutë të re mund të zgjasë me muaj,



shkruan agjencia "AFP". Trembëdhjetë vjet pas anëtarësimit në BE, Bullgaria

mbetet anëtarja e saj më e varfër, sipas organizatës "Transparency International".

Raporti 24-orësh i IKShPK-së: Gjashtë të vdekur, 131 të shëruar dhe 112 raste të reja me Covid

Mbi 13 mijë raste pozitive me Covid në Kosovë që nga fillimi i pandemisë

Krahasuar me numrin e popullsisë dhe të testimeve, në Kosovë numri i rasteve pozitive me Covid vazhdon të jetë i lartë. Që nga rasti i parë me Covid në muajin mars e deri më tani në vendin tonë janë infektuar nga virusi "Korona" 13 713 qytetarë. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se nga ky numër, 9 923 persona janë shëruar dhe 539 të tjerë kanë ndërruar jetë. Ky institut ka bërë me dije se në 24 orët e fundit nga koronavirusi kanë ndërruar jetë gjashtë persona, 131 janë shëruar dhe janë paraqitur 112 raste të reja



**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit kanë vdekur gjashtë persona si pasojë e infektimit me virusin "Korona". Po ky institut ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar 131 persona dhe janë paraqitur 112 raste të reja me Covid. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK, me metodën RT-PCR dhe në laboratorët privatë, janë testuar gjithsej 488 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 112 raste pozitive.

Brenda 24 orëve janë raportuar 6 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Numri total i rasteve pozitive është 13 713 raste nga 52 157 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 539 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 131 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 9 923 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 251", ka njoftuar IKShPK-ja, duke treguar numrin e rasteve sipas komunave të prekura nga Covidi. "Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 36 raste, komuna Gjakovë 16 raste, komuna Gjilan 10 raste, komuna Pejë 7 raste, komuna Viti 5 raste, komuna Deçan 4 raste, komuna Drenas 4 raste, komuna Lipjan 4 raste, komuna

Malishevë 4 raste, komuna Ferizaj 3 raste, komuna Mitrovicë 3 raste, komuna Skenderaj 3 raste, komuna Fushë Kosovë 2 raste, komuna Klinë 2 raste, komuna Suharekë 2 raste dhe me nga një rast komunat Kamenicë, Klokot, Obiliq, Podujevë, Prizren, Rahovec dhe Vushtrri", ka njoftuar IKShPK-ja.

QMF-ja e Reçanit pranon materiale mjekësore për mbrojtje nga Covid

Ministri i Shëndetësisë (MSh), Armend Zemaj, të mërkurën ka vizituar Qendrën e Mjekësisë

Familjare (QMF) në Reçan të Prizrenit, ku me stafin menaxhues të kësaj qendre kanë biseduar për shqetësimet që ka krijuar Covid-19, për menaxhimin e situatës si dhe projektet që do të realizohen në të ardhmen. Zemaj ka bërë me dije se gjatë kësaj vizite kanë dërguar një donacion me materiale mjekësore mbrojtëse. "Në konkurset e fundit të MSh-së për rritjen e kapaciteteve mjekësore dhe inspektuese kemi pranuar edhe profesionistë edhe nga kjo trevë, të cilët do të jenë të angazhuar në institucione shëndetësore në Republikën e Kosovës. QMF-ja e Reçanit është në koordinim të

vazhdueshëm me Ministrinë e Shëndetësisë. Kjo qendër do ta ketë përkrahjen time, do të mbështeten projekte të caktuara e do të ofrohet ndihmë për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore. E falënderova stafin menaxhues dhe personelin shëndetësor për përkushtimin dhe punën e palodhur që është duke bërë në këtë kohë të vështirë", ka thënë Zemaj.

Ligji për Sigurimet Shëndetësore , Zemaj takohet me zyrtarët e MSh-së

Ministri i Shëndetësisë (MSh), Armend Zemaj, ka mbajtur një takim me zyrtarët përgjegjës për hartimin e legjislacionit në kuadër të kësaj ministrie. Në këtë takim është biseduar për kompletimin e kuadrit ligjor, si dhe rreth dinamikës për përgatitjen dhe hartimin e Ligjit për Sigurimet Shëndetësore dhe plotësimin me aktet nënligjore të ligjeve përkatëse. "Jemi të përkushtuar dhe po angazhohemi që sa më parë të kompletohet kuadri ligjor, të funksionalizohen ligjet që kanë të bëjnë me shëndetësinë dhe qytetarëve t'u ofrohen shërbime më cilësore shëndetësore", ka thënë Zemaj.



FLET PËR “EPOKËN E RE”, EDITA TAHIRI

TAKIMI I UASHINGTONIT DO TË SHËNOJË HAPA PËRPARA DREJT NJOHJES RECIPROKE

- Në delegacionin e Kosovës do të duhej të përfshiheshin edhe partitë opozitare

Ish-kryenegociatorja e Kosovës në dialogun me Serbinë, Edita Tahiri, ka bërë me dije se takimi në Uashington ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të shënojë hapa përpara drejt njohjes reciproke. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ajo ka thënë se në këtë takim nuk mund të arrihet marrëveshja përfundimtare në mes të dy shteteve. Tahiri ka thënë se nëse ndodh arritja e ndonjë marrëveshje ekonomike, ajo duhet të ketë kornizë të qartë politike. Në të kundërtën, sipas saj, marrëveshjet do ta cenonin shtetësinë e Kosovës

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Ish-kryenegociatorja e Kosovës në dialogun me Serbinë, Edita Tahiri, e ka vlerësuar shumë të rëndësishëm takimin e 4 shtatorit, me të cilën datë do të takohet delegacioni i Kosovës dhe ai i Serbisë në Shtëpinë e Bardhë për të biseduar. Ajo ka deklaruar se në këtë takim do të shënohen hapa përpara drejt njohjes reciproke në mes të dy shteteve.

Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Tahiri ka bërë me dije se nuk pret që në këtë takim të ndodhë përfundimtare. “Ky takim do të shënojë hapa përpara drejt njohjes reciproke mes dy shteteve, por nuk pres përfundimtare të marrëveshjes. Është folur zyrtarisht se do të jetë agjendë ekonomike, mirëpo unë besoj se nuk mund t’iu shmangen temave të tjera. Sepse gjërat janë të

ndërlidhura dhe në Ballkan është vështirë të ndahen temat ekonomike nga ato politike, apo gjeopolitike”, ka thënë Tahiri. Ajo ka treguar se nga ky takim mund të pritët arritja e ndonjë marrëveshje ekonomike. Sipas Tahirit, marrëveshjet ekonomike duhet të kenë kornizë të qartë politike. “Nëse do të ketë marrëveshje ekonomike, ajo marrëveshje duhet të ketë kornizë të qartë politike. Pra, të jetë marrëveshje mes dy shteteve të pavarura dhe sovraane. Këtë po e theksoj, sepse nëse do të kemi një marrëveshje vetëm ekonomike, pa aspektin bilateral shtetëror, atëherë do të ishte një marrëveshje e cila do ta cenonte shtetësinë e Kosovës”, është shprehur ajo. Më tej, Tahiri ka folur edhe për përbërjen e delegacionit shtetëror që do ta përfaqësojë Kosovën në këtë takim. Ajo ka thënë se në delegacion do të duhej të përfshiheshin edhe subjektet politike opozitare.

“Mendoj se qeveria aktuale dhe parterët e koalicionit qeveritar është dashur të bëjnë çmos, pra t’i përdorin të gjitha mundësitë që të përfshihet opozita në delegacion. Sepse ne sot kemi një opozitë shumë të fortë. Kështu që, ka qenë e domosdoshme të gjendet rruga që subjektet opozitare të jenë pjesë e delegacionit. Kjo rrugë nuk është e thjeshtë dhe nuk bëhet vetëm me një ftesë”, ka thënë Tahiri.

“Epoka e re”: Znj. Tahiri, delegacioni i Kosovës ka shkuar në Uashington për takimin e 4 shtatorit në Shtëpinë e Bardhë. Si e keni parë përbërjen e tij?

Tahiri: Duke marrë parasysh që takimet në Uashington kanë një rëndësi të jashtëzakonshme, jo vetëm për Kosovën, por edhe për mbarë rajonin, dhe duke marrë parasysh që kemi hyrë në fazën finale të bisedimeve me Serbinë, mendoj se do të duhej të kishim një delegacion

uniteti. Pra, një delegacion me një bazë më të zgjedhur, ku patjetër do të duhej të përfshiheshin edhe partitë opozitare. Pastaj, ky delegacion do të duhej ta kishte aprovimin e Kuvendit të Kosovës dhe të kishte një platformë për bisedime të miratuar në Kuvend. Sepse kjo fazë e dialogut dallon nga fazat e tjera ngaqë e ka karakterin e proceseve finale. Kështu si është, delegacioni ka bazë institucionale, sepse është qeveritar, pastaj rezoluta e Kuvendit e ka mandatuar qeverinë që të merret me dialogun Kosovë - Serbi. Meqenëse kjo është një fazë tjetër e dialogut, do të duhej edhe delegacioni i Kosovës të reflektonte peshën më të madhe dhe legjitimitetin më të madh.

“Epoka e re”: Përveç mungesës së opozitës, delegacioni është kritikuar edhe për mungesë të përvojës në negociata dhe mospërfshirjen e ekspertëve. Është e drejtë kjo kritikë?

Tahiri: Natyrisht se këto janë karakteristika të domosdoshme për një delegacion i cili bën negociata për paqe, sidomos në këtë rast kur negocion me armikun, pra me Serbinë, e cila ka qenë okupatore. Në këtë drejtim më shumë nuk do të komentoja, sepse vetë jam negociatore gati mbi dy dekada. Mjafton që kanë folur të tjerët.

“Epoka e re”: A ka qenë qasja e duhur e qeverisë ndaj opozitës për përfshirje në këtë delegacion?

Tahiri: Mendoj se qeveria aktuale dhe parterët e koalicionit qeveritar është dashur të bëjnë çmos, pra t’i përdorin të gjitha mundësitë që të përfshihet opozita në delegacion. Sepse ne sot kemi një opozitë shumë të fortë. Janë dy parti të mëdha në opozitë. Kështu që, ka qenë e domosdoshme që të gjendet rruga që subjektet opozitare të jenë pjesë e delegacionit. Kjo rrugë nuk është e thjeshtë dhe nuk bëhet vetëm me një ftesë.



Burrë e grua i bashkohen Vetëvendosjes

PRISHTINË, 2 SHTATOR (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka bërë me dije se Merita dhe Ismet Januzi i janë bashkuar kësaj lëvizje. Kurti ka thënë se dyshja e re e anëtarësuar në Vetëvendosje kanë një përvojë profesionale në çështje të menaxhimit, bujqësisë, biznesit, arsimit të mesëm dhe të lartë. “Merita dhe Ismeti, dy bashkëshortët, që kanë një përvojë profesionale në çështje të menaxhimit, bujqësisë, biznesit, arsimit të mesëm dhe të lartë, u anëtarësuan në Lëvizjen

tonë. Merita Berisha Januzi bart titullin doktor shkence për menaxhim nga Universiteti MIT në Shkup, kurse magistraturën për Shkenca të Ekonomisë dhe bachelorin si Inxhinierë e Bujqësisë e ka të përfunduar në Universitetin e Prishtinës. Merita është mësimdhënëse dhe profesore në ShML ‘Zenel Hajdini’ dhe Kolegjin ‘Vizioni për Arsim’ në Ferizaj. Ismet Januzi ka përfunduar magistraturën për Marketing dhe Menaxhment në Universitetin e Tetovës, kurse

bachelorin për Marketing dhe Administrim Biznesi në Prishtinë. Ismeti punon si menaxher në biznesin NTP ‘Arb-Rini’ dhe është drejtor i Kolegjit ‘Vizioni për Arsim’ në Ferizaj. Merita dhe Ismeti jetojnë në Ferizaj dhe janë prindër të dy djemve. Me përkushtimin, dijen dhe angazhimin e tyre shtesë në Lëvizjen Vetëvendosje, Merita dhe Ismeti do të ndihmojnë në rikthimin e qeverisjes sonë për jetësimin e ndryshimeve pozitive që i synojmë”, ka thënë Kurti.





sepse nëse do të kemi një marrëveshje vetëm ekonomike, pa aspektin bilateral shtetëror, atëherë do të ishte një marrëveshje e cila do ta cenonte shtetësinë e Kosovës. Po e them këtë sepse janë bërë disa marrëveshje në Gjermani me ndërmjetësimin amerikan, pra ato dy-tri marrëveshjet ekonomike, ku në bazë të dokumenteve që kam lexuar, i mungon aspekti politik i definimit që këto janë marrëveshje mes dy shteteve të pavarura dhe sovraane. Në Gjermani kanë ndodhur, mirëpo në këtë fazë nuk duhet të ndodhë, sepse një gjë e tillë do ta dëmtonte shtetasin e Kosovës. Ky do të ishte dështim i punës së delegacionit të Kosovës.

“Epoka e re”: *Ka pasur edhe pasiguri që janë shprehur ndaj këtij takimi. Cila është përgjigjja e juaj ndaj dilemave të tilla?*

Tahiri: Kam dëgjuar edhe paralajmërimet se do të ketë befasi në këtë takim. Sidomos këtë e alarmon Serbia që të krijojë pasiguri dhe frikë. Mirëpo mendoj se ne nuk duhet ta kemi drojën prej këtyre proceseve. Këto janë procese negociatore dhe, në qoftë se do të ketë befasi jo të mira, atëherë delegacionit të Kosovës i takon që të çohet nga tavolina, sepse delegacioni i Kosovës ka mandat të qartë, i ka vijat e kuqe, e di se duhet të angazhohet për mbrojtjen e shtetit dhe sovranitetit dhe integritetit territorial. Pra, e di delegacioni i Kosovës se çdo marrëveshje duhet të jetë brenda Kushtetutës së Kosovës. Pra, pavarësisht që ndërmjetësuese e bisedimeve është aleatja jonë kryesore, me përkrahjen e së cilës i kemi arritur lirinë dhe pavarësinë, megjithatë në negociatë, kur gjërat nuk shkojnë mirë në tavolinë, atëherë duhet të largohesh nga tavolina. Kështu që, për ato frikësime e befasi ekziston përgjigjja. Megjithatë, unë besoj se do të ketë rrjedha pozitive sepse sa herë që ShBA-ja është angazhuar në Kosovë dhe Ballkan, gjërat kanë shkuar në rrugën e duhur.

Është dashur të ulen liderët e partive politike parlamentare dhe ta shikojnë mundësinë e riformatimit të qeverisë për ta përfshirë opozitën në qeveri. Pastaj, do të kishim një delegacion më të gjerë. Sepse në fund çdo marrëveshje finale do të shkojë në Kuvend, ku do të kërkohen dy të tretat e votave për miratim. Nëse kësaj radhe nuk ka ndodhur, duhet të ndodhë herën tjetër një gjë e tillë.

“Epoka e re”: *Përfshirja e opozitës në delegacion, do të ndikonte në fuqizimin e*

pozicionit të Kosovës në takim?
Tahiri: Sa i përket fuqizimit të pozicionit të Kosovës, mendoj se tani Kosova ekziston si shtet i pavarur falë luftës çlirimtare të popullit të Kosovës dhe aleatëve tanë amerikanë dhe evropianë. Dhe në Uashington ndërmjetësuese është Amerika, aleatja jonë kryesore, e cila ka qenë pjesë çlirimtare dhe pavarësimi të Kosovës. Por, sa i takon legjitimitetit, natyrisht se kur është një delegacion që përfaqëson të gjitha partitë, karshi palës serbe, por edhe në raport me ndërmjetësuesin, do të ishte një fuqi më e madhe,

më serioze e delegacionit tonë.
“Epoka e re”: *Qeveria ka paralajmëruar se në takimin e 4 shtatorit do të diskutohet për çështje ekonomike, ndërsa Lëvizja Vetëvendosje ka deklaruar se mund të ketë edhe marrëveshje politike. Çfarë pritni se do të diskutohet në këtë takim?*

Tahiri: Së pari mendoj se takimi në Uashington ka vërtet një rëndësi të jashtëzakonshme strategjike sepse tregon angazhimin e rritur të Amerikës për Kosovën dhe stabilitetin në rajonin e Ballkanit. Së dyti, ky takim do të

shënojë hapa përpara drejt njohjes reciproke mes dy shteteve, por nuk pres përmbyllje të marrëveshjes. Është folur zyrtarisht se do të jetë agjendë ekonomike, mirëpo unë besoj se nuk mund t’iu shmangen temave të tjera. Sepse gjërat janë të ndërlidhura dhe në Ballkan është vështirë të ndahen temat ekonomike nga ato politike apo gjeopolitike. Nëse do të ketë marrëveshje ekonomike, ajo marrëveshje duhet të ketë kornizë të qartë politike. Pra, të jetë marrëveshje mes dy shteteve të pavarura dhe sovraane. Këtë po e theksoj,

Veseli bisedon me strukturat e PDK-së në Podujevë për situatën politike në vend



PODUJEVË, 2 SHTATOR (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, i shoqëruar nga anëtarë të kryesisë qendrore, ka takuar strukturat në Podujevë. Kryetari Veseli ka folur për sfidat me të cilat po ballafaqohet vendi gjatë kësaj periudhe, përfshirë situatën politike dhe atë me pandeminë. Ai ka përgëzuar

dhe mbështetur strukturat e Podujevës për punën e madhe që kanë bërë së fundmi për ta nxitur reagimin qytetar ndaj keqpërdorimeve. Ndërsa kryetari i Degës së Podujevës, Naim Fetahu, ka falënderuar kryetarin Veseli për mbështetjen e përzërvë për këtë degë dhe është zotuar për një qytet më të mirë.

Shërbimi Korrektues dhe Oda e Avokatëve pajtohen për vazhdimin e bashkëpunimit



PRISHTINË, 2 SHTATOR (ER) - Drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK), Nehat Thaçi, ka pritur në takim kryetarin e Odës së Avokatëve, Behar Ejupi, nënkryetarin e kësaj ode, Naim Rudari dhe kryetarin e Degës Regionale të Avokatëve të Prishtinës, Nasuf Hasani. Në

takim është diskutuar rreth sfidave dhe çështjeve me rëndësi për avokatët dhe institucionet korrektuese, si dhe ato të paraburgimit në kohë pandemie.

Gjatë takimit, Thaçi i ka njoftuar të pranishmit në lidhje me menaxhimin dhe masat e marra për parandalimin e

pandemisë Covid-19 në institucionet korrektuese dhe atyre të paraburgimit, si dhe mbi gjendjen aktuale në përgjithësi në institucionet korrektuese.

Ndërsa kryetari i Odës së Avokatëve, Behar Ejupi, e ka përgëzuar Thaçin për menaxhimin e situatës dhe të

parandalimit të përhapjes së infektimit në institucionet korrektuese dhe ato të paraburgimit. Më tutje, ai ka kërkuar që në varësi të situatës dhe konform rekomandimeve dhe udhëzimeve për mbrojtje nga pandemia Covid-19, të mundësohet qasja më e lehtë për avokatët në institucionet

korrektuese.

Në fund të takimit, të dyja palët janë pajtuar që të vazhdohet me bashkëpunimin dhe komunikimin e rregullt ndërinstytucional, me qëllim të identifikimit dhe avancimit të të gjitha çështjeve, të cilat janë me rëndësi për të dyja institucionet.

Kryetarët e komunave nuk do ta votojnë rishikimin e buxhetit për kornizën afatmesme të shpenzimeve

**EPOKA
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Kryetarët e komunave në takimin e së mërkurës me ministrin e Financave, Hykmete Bajrami dhe ministrin e Pushtetit Lokal, Goran Rakiq, kanë vendosur që të mos e votojnë në Komisionin e Granteve rishikimin e buxhetit në kuadër të rishikimit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2021-2023 (KASH). Sipas tyre, arsyeja kryesore është që Ministria e Financave ka paraparë shkurtime buxhetore për vitin 2021 në raport me vitin 2020 në vlerë prej 32.95 milionë eurosh për komuna. Me shkurtrimin e buxheteve komunale do të ndërpriten shumë projekte kapitale të

cilat do të ndikojnë në mospërmirësimin e jetës së qytetarëve.

Kryetarët njëzëri konstatuan që 32.95 milionë euro mund të duken si shumë e vogël parash për nivelin qendror, por këto mjete janë shumë për komunat. Kryetarët, gjithashtu, dhanë edhe alternativën sa i përket gjetjes së mjeteve për mbulimin e kësaj shume duke propozuar që dy apo tri projekte të ndërpriten në nivel qendror dhe që ato mjete të dedikohen për komuna.

Kryetarët e komunave, që janë anëtarë në komisionin e granteve, nuk do ta votojnë propozimin për shkurtrimin e buxheteve komunale gjatë rishikimit të Buxhetit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2021-2023.



Mjekët e ORL-së në QKUK ia shpëtojnë jetën foshnjës nëntëmuajshe

PRISHTINË, 2 SHTATOR (ER) - Mjekët e ORL-së në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës i kanë shpëtuar jetën foshnjës nëntëmuajshe me përkatësi etnike serbe, duke ia hequr një kokërr të fasules nga bronku kryesor i mushkërisë së djathtë.

Ndërhyrja ka zgjatur rreth 40 minuta dhe trupi i huaj është larguar me procedurën e quajtur bronkoskopi. Foshnja e gjinisë mashkull nga komuniteti serb, me vendbanim në Komunën e Kamenicës, ishte dërguar, fillimisht, në Spitalin e Gjilanit. Pas problemeve të theksueshme me

frymëmarrje, mjekët e kanë intubuar pacientin dhe me urgjencë e kanë nisur në Prishtinë. Gjendja shëndetësore e foshnjës është e mirë.

Milica Stojković, nëna e fëmijës, ka falënderuar mjekët për punën e bërë, derisa ka mbetur e habitur me pritjen dhe shërbimet e ofruara. "Jashtëzakonisht jemi të kënaqur me mënyrën se si është trajtuar foshnja jonë. Nuk kam fjalë ta përshkruaj. Këtu njerëzit nuk dallohen në bazë të nacionalitetit. Çdo serb që ka probleme shëndetësore, mund të vijë këtu pa asnjë problem", ka thënë Stojković.

Pas Shtëpisë së Bardhë, Hoti dhe Vuçiqi të hënën shkojnë në Bruksel

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Zëdhënësi i BE-së për Çështje të Jashtme dhe të Sigurisë, Peter Stano, ka konfirmuar se do të vazhdojë dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian më 5, 6 dhe 7 shtator. Sipas tij, të hënën do të zhvillohet takimi në nivel të lartë, në mes të kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ndërsa gjatë kësaj fundjave do të zhvillohen bisedime në nivel të ekspertëve. Ai ka thënë se liderët politikë të hënën do të priten nga përfaqësuesi i lartë i BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell dhe përfaqësuesi i posaçëm për dialog, Miroslav Lajçak. Ky zëdhënës i BE-së ka paralajmëruar se në takimin e së hënës do të diskutohen çështjet që kanë të bëjnë me "aranzhimet për komunitetet joshumicë dhe çështjet e kërkesave financiare dhe të pronësisë nga ana e palëve". Ai nuk ka dashur të tregojë hollësi rreth këtyre temave.

I pyetur se a do të diskutohet edhe për dëmet e luftës, një çështje që në opinion është përmendur shpesh nga zyrtarët e Kosovës, Peter Stano ka thënë se vetë ideja e takimit është që të diskutohet për të gjitha çështjet e hapura mes palëve.

Stano, po ashtu, ka refuzuar që të saktësojë se a kanë të drejtë apo jo palët në interpretimet e tyre për dialogun, me palën e Kosovës që thotë se është vetëm dialog politik që do të rezultojë me njohje dhe atë të Serbisë se nuk diskutohet për njohjen. "Ky është një dialog që do të rezultojë me një normalizim të raporteve mes palëve dhe që do të përmbylej me një marrëveshje ligjërshite obliguese", ka thënë ky zëdhënës i BE-së, duke shtuar se interpretimet dhe qëndrimet shpesh të ndryshme të palëve janë pjesë përbërëse e këtij procesi. "Ne jemi lehtësues e jo komentues të dialogut", ka thënë ai në një konferencë për media.

Burimet e BE-së kanë paralajmëruar se gjatë fundjavës, të shtunën dhe të dielën, në



Bruksel do të ketë takime edhe nga ana e ekspertëve, të cilët do të merren me çështjet e të zhvendosurve dhe bashkëpunimit ekonomik, tema këto të cilat ishin në rend ditë në dy takimet e fundit.

Qëllimi është që palët sa më shumë të afrohen për këto tema


dhe, mundësisht, edhe të bien dakord, thonë burimet e BE-së.

Takimet në Bruksel këtë fundjavë dhe të hënën vijnë menjëherë porsa të kenë përfunduar takimet në Uashington në mes të Kosovës dhe Serbisë, të thirrura dhe ndërmjetësuar nga administrata e Shteteve të Bashkuara të

Amerikës.

Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë i ndërmjetësuar nga BE-ja rifilloi më 16 korrik, pasi ishte ndërprerë në fund të vitit 2018, kur Qeveria e Kosovës vendosi taksën 100 për qind ndaj produkteve të importuara nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina.

Ambasada britanike: Jemi të përkushtuar për partneritet me Kosovën



PRISHTINË, 2 SHTATOR (ER) - Ambasada e Britanisë së Madhe në Kosovë ka njoftuar se të mërkurën një ministri e re në Britani të Madhe do ta integrojë Zyrën për Marrëdhënie të Jashtme të Britanisë në Ministri për Marrëdhënie të Jashtme dhe Departamentin për Zhvillim Ndërkombëtar. Në këtë kontekst, kjo ambasadë ka theksuar se Britania e Madhe është e përkushtuar për partneritet me Kosovën. "Sot shënohet dita e parë e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Zyrës për Zhvillim, një ministri e re në Britaninë e Madhe që integron Zyrën për Marrëdhënie me Jashtë dhe Departamentin

për Zhvillim Ndërkombëtar. Ministria do ta integrojë zhvillimin dhe diplomacinë në një departament të vetëm që do të sjellë përpjekjet më të mëdha ndërkombëtare të Britanisë, duke vepruar si forcë për të mirë në botë dhe duke i mbrojtur interesat kombëtare të Britanisë. Ne vazhdojmë të jemi plotësisht të përkushtuar për partneritetin tonë me Kosovën, për t'u fuqizuar në marrëdhëniet tona historike, për të sjellë një të ardhme më të mirë për qytetarët e Kosovës", është thënë në njoftimin e Ambasadës së Britanisë së Madhe të publikuar në faqen zyrtare në "Twitter".

"Handikos"-i dhuron tabletë për 12 fëmijë me aftësi të kufizuara

Prishtinë, 2 shtator - Dymbëdhjetë fëmijë me aftësi të kufizuara, anëtarë të grupit avokues "Hëna", tashmë do ta kenë më të lehtë pjesëmarrjen e tyre në aktivitete apo takime virtuale, pas pajisjes me tabletë të rinj dhe të përshatshëm për ta. "Handikos" ka arritur që shpërndarjen e

tabletëve ta bëjë në katër komuna target, atë të Prishtinës, të Mitrovicës, të Ferizajt dhe të Gjakovës. Ky intervenim është realizuar në kuadër të projektit "Promovimi i parandalimit të dhunës në të gjitha mjediset ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë", në partneritet me

"Save the Children", Zyra në Kosovë dhe "SIDA"-n suedeze. Grupi avokues i fëmijëve "Hëna" është grup joformal i themeluar nga "Handikos" dhe i mbështetur nga "Save the Children" që nga viti 2017, me mision garantimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë.



Mustafa: Do t'i përkrahim bujqit e Vushtrrisë

VUSHTRRI, 2 SHTATOR (ER) - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, ka vazhduar vizitat në terren, për ta ofruar mbështetjen për bujqit e prekur nga dëmet e breshrit dhe reshjeve të fundit të shiut në vendin tonë.

Ministri Mustafa, i shoqëruar nga kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri si dhe deputetja Rrezarta Krasniqi, kanë qëndruar në fshatrat e kësaj komune, ku janë njoftuar nga afër me dëmet e shkaktuara në veprimtaritë bujqësore të fermerëve të këtij rajoni. "Gjatë këtij viti sektori i bujqësisë ka pësuar dëme të

shumta nga breshri dhe reshjet e shiut, të cilat ua kanë vështirësuar veprimtaritë fermerëve tanë. Duke parë gjendjen me të cilën po ballafaqohen, do të angazhohemi në vazhdimësi që t'ua ofrojmë mbështetjen për t'i tejkaluar dëmet e shkaktuara", ka thënë Mustafa.

Ministri Mustafa i ka njoftuar ata se tashmë komisionet e përbashkëta në mes të ministrisë dhe komunave janë duke e kryer punën e tyre për evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve nga breshëri, të cilat do të kompensohen brenda mundësive buxhetore të ministrisë.



Nënshkruhet memorandum i mirëkuptimi ndërmjet Kosovës dhe Sllovenisë në fushën e regjistrimit të bizneseve



Prishtinë, 2 shtator (ER) - Në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë u bë nënshkrimi, në mënyrë virtuale, i memorandumit të mirëkuptimit në mes të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve Kosovare të Republikës së Kosovës dhe Agjencisë për Regjistrat Ligjorë, Publikë dhe Shërbimet Përkatese të Republikës së Sllovenisë.

Ky memorandum ka për qëllim bashkëpunimin në fushën e regjistrimit, ndryshimit dhe shuarjes së bizneseve duke konsistuar në fushën e

teknologjisë më të re dhe më të avancuar për regjistrimin e bizneseve.

Drejtoresha e Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve Kosovare, Nexhmie Selimi, me rastin e nënshkrimit të memorandumit, tha se ky memorandum ka për qëllim angazhimin për ta promovuar bashkëpunimin në mes të institucioneve përgjegjëse të Kosovës dhe Sllovenisë, si dhe për ta përmirësuar inovacionin dhe për t'i forcuar sistemet kombëtare të regjistrimit të bizneseve për të garantuar administrim të duhur

në mbrojtjen dhe përdorimin e të drejtave procedurale.

Sipas drejtoreshës Selimi, qëllim i këtij memorandum është edhe themelimi i një kornize bashkëpunimi për bashkëpunim ndërkufitar dhe realizim të aktiviteteve të përbashkëta në mes palëve.

Ndërkaq sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Burim Rreci, e konsideroi këtë memorandum të frytshëm për forcimin e bashkëpunimit institucional në fushën e regjistrimit të bizneseve në mes dy vendeve.

Tahiri në Ferizaj: Angazhimi i qeverisë do të jetë në tri shtylla kryesore

FERIZAJ, 2 SHTATOR (ER) - Zëvendëskryeministri i parë, Besnik Tahiri, së bashku me zëvendësministrin e Infrastrukturës, Xhavit Zariqi, të mërkurën ka vizituar Komunën e Ferizajt, ku janë pritur nga kryetari i kësaj komune, Agim Aliu.

Zëvendëskryeministri Tahiri në këtë takim ka falënderuar Aliun për përkushtimin dhe angazhimin e tij si dhe ka konfirmuar mbështetjen e Qeverisë së Kosovës për çështje të rëndësishme zhvillimore dhe për ndërtimin e kapaciteteve për luftën me pandeminë për Komunën e Ferizajt. "U pajtuam të zhvillojmë një takim konsultativ mbi temën e reformave me qëllim të ndryshimit të legjislacionit në

nivelin lokal. Gjatë vizitës kisha kënaqësinë ta vizitoja Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Ferizaj dhe personelin mjekësor të kësaj qendre. Falënderoj kryetarin Aliu dhe të gjithë profesionistët mjekësorë për angazhimin e tyre në luftën kundër Covid-19", ka thënë Tahiri. Ai ka thënë se angazhimi i qeverisë do të jetë në tri shtylla kryesore: Rishikimi i financimit në nivelin lokal; Funkcionalizimi i sektorit shëndetësor për luftën ndaj Covid-19; dhe Shtyrja përpara e procedurave të miratimit të Ligjit të Pagave. "Dora e parë e ndihmës për qytetarët e Kosovës në kohën e pandemisë janë komunat dhe personeli mjekësor komunal, andaj është jetike që të përkrahjet nivelin lokal", ka thënë Tahiri.



Ministri Reçica në Tiranë për të hedhur hapa drejt bashkimit të tregut të punës



prej nga vijnë. Në këtë kuptim ne po afrojmë edhe më shumë Vlorën me Podujevën, shkodranët me pejanët dhe, po ashtu, gjilanasit në Elbasan të ndihet elbasanas”, ka thënë ministri Reçica.

Ai ka shtuar se kuadrot e të dyja vendeve me arritjen e kësaj marrëveshje do ta shfrytëzojnë tregun e përbashkët të punës i cili do të jetë i integruar në vetëm një treg pune. “Rëndësia e integritetit është që dy vendet tona t’i plotësojnë vendet e lira të punës, të cilat kërkojnë kuadro në bazë të nevojave të tregut. Me këtë marrëveshje do të mundësohet mbulimi i këtij boshllëku duke ofertuar fuqinë punëtore me përgatitjen profesionale sipas nevojave të tregut të punës të të dy vendeve tona”, është shprehur ministri Reçica.

Gjithashtu, ai ka bërë me dije se me ministren Denaja u morën vesh që pas arritjes së kësaj marrëveshje duhet ta realizojnë edhe marrëveshjen për sigurime sociale, që qytetarët e të dy vendeve mos t’i humbasin kontributet e tyre dhe t’i bashkojnë periudhat e kontributeve nga secili vend që kanë punuar. “Pra, qytetarët tanë do të përfitojnë nga sigurimet shoqërore duke zgjedhur të jetojnë ku ata dëshirojnë, në Kosovë apo në Shqipëri. Me arritjen e këtyre dy marrëveshjeve Kosova dhe Shqipëria do të jenë gjithnjë e më afër Bashkimit Evropian, për faktin se po jetësojmë një pjesë të procesit të Berlinit, mbi të gjitha me këto marrëveshje ne do të jemi më pranë njëri-tjetrit”, ka theksuar ministri Reçica.

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka takuar të mërkurën në Tiranë ministren e Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Shqipërisë, Anila Denaj, me të cilën ka diskutuar për hapat drejt bashkimit të tregut të punës. “Me ministren e nderuar, znj. Denaj, u morëm vesh për arritjen e marrëveshjes së mobilitetit në punë, marrëveshje kjo e cila ua mundëson qytetarëve të vendeve tona të kenë mundësi të barabarta punësimi, arsimit dhe aftësimi profesional”, është shprehur Reçica

EPOKA E RE

Albulena S. MAVRAJ

TIRANË, 2 SHTATOR - Në prag të mbledhjes së radhës së dy qeverive tona, të mërkurën ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, bashkë edhe me ambasadorin e Kosovës në Shqipëri, Nait Hasani, takuan ministren e Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Shqipërisë, Anila Denaj, për t’i shtuar edhe më tej

veprimet e nevojshme në rrugëtimin e nisur qëmoti për lehtësimin e jetës së qytetarëve tanë. “Me ministren e nderuar, znj. Denaj, u morëm vesh për arritjen e marrëveshjes së mobilitetit në punë, marrëveshje kjo e cila ua mundëson qytetarëve të vendeve tona të kenë mundësi të barabarta punësimi, arsimit dhe aftësimi profesional, anekënd hapësirës sonë geografike, pavarësisht vendit

Rezervat e arit të Bankës së Shqipërisë arrijnë vlerën më të lartë historike

TIRANË, 2 SHTATOR - Rezervat e arit të Bankës së Shqipërisë arritën në fund të korrikut vlerën rekord të 147 milionë eurove. Statistikat e Bankës Qendrore tregojnë se rezervat e arit janë rritur me 73 për qind krahasuar me një vit më parë. Rritja e vlerës së arit ka ardhur njëkohësisht nga zgjerimi i investimeve të bankës qendrore në këtë instrument, por edhe nga rritja e çmimit në tregjet ndërkombëtare. Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, në intervalin kohor korrik 2019 - korrik 2020 vlera e arit është rritur rreth 32 për qind dhe ky ka rezultuar fitimprurës si instrument i investimit të rezervës valutore të vendit. Aktualisht, një onz ar

kuotohet në vlerën e 206 mijë lekëve ose rreth 1 660 euro. Kriza e Covid-19 dhe “përmbytja” e tregut me likuiditet për ta ndihmuar ekonominë kanë rritur kërkesën për metale të çmuara, që perceptohen nga investitorët si asetet më të sigurta për ruajtjen e vlerës në kohë krizash. Ari monetar përbën tashmë 3.6 për qind të rezervës valutore të Shqipërisë, ndërsa në muajin maj kishte arritur peshën më të lartë specifike të regjistruar ndonjëherë, me 3.9 për qind të totalit. Pas rritjes së fortë të rezervës valutore nga fondet e eurobondit në muajin qershor, pesha specifike e arit pësoi një rënie të lehtë.



Eurobondi bëri që rezerva valutore e vendit që në mesin e këtij viti të kalonte për herë të parë kufirin e 4 miliardë

eurove. Në fund të korrikut, vlera e mjeteve të rezervës ishte 4.12 miliardë eurove ose afërsisht sa 32 për qind e

Prodhimit të Brendshëm Bruto. Kjo shumë është gati katër herë sa deficitit i llogarisë korente të vitit të kaluar.

QKMF-ja e Mamushës do të bëhet me objekt të ri

MAMUSH, 2 SHTATOR (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, së bashku me kryetarin e Mamushës, Abdulhadi Krasnic, kanë nënshkruar memorandumin për "Ndërtimin e objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare", me vlerë 738 922 euro. Zemaj ka thënë se me këtë rast pritet të rritet edhe personeli mjekësor. Në këtë ceremoni ishin edhe ambasadori i Turqisë, Çağrı Sakar, komandanti i KFOR-it turk, Savaş Yanar, koordinatori i TIKa-s, Cihan Dinçer, ministri MZHR-së,

Enis Kervan, deputeti Fidan Jilta dhe kryetari i KDTP-së, Fikrim Damka. "E rikonfirmova se kjo komunë dhe komunitetet e tjera do ta kenë vëmendjen dhe mbështetjen e plotë. Për Mamushën do të ketë specializime për mjekësinë familjare dhe biokiminë klinike, të cilët do të punojnë në QKMF", ka thënë Zemaj. Me këtë rast është bërë edhe pranim-dorëzimi i autoambulancës, donacion nga KFOR-i turk dhe Turqia, e cila do të jetë në shërbim të pacientëve të kësaj komune.



Inspektohen punimet e disa projekteve në Prizren



PRIZREN, 2 SHTATOR (ER) - Komuna e Prizrenit ka njoftuar se Drejtoria e Shërbimeve Publike ka bërë inspektimin e punimeve në kanalet e ujërave atmosferike, kanalizimit të ujërave të zeza, të rrugëve lokale dhe ato të ndriçimit publik në Krushë të Vogël, me ç'rast operatori ekonomik

është urdhëruar për sanimin e gjendjes. "Drejtoria e Shërbimeve Publike njofton se projektet e radhës do të sinkronizohen për të qenë në përputhje me kërkesat e banorëve të këtij fshati", ka njoftuar Komuna e Prizrenit. Po ashtu, kjo komunë ka njoftuar se inspektorati komunal në bashkëpunim

me inspektoratin e komunikacionit nga Drejtoria e Shërbimeve Publike kanë organizuar një aksion me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve për të mos parkuar dhe për të mos hyrë në Qendrën Historike të Prizrenit pa e marrë lejen nga organet kompetente.

Nënshkruhet kontrata për trajtimin e shtretërve të përrenjve të Rahovecit

RAHOVEC, 2 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka bërë me dije se të mërkurën ka nënshkruar kontratën për realizimin e projektit "Trajtimi i shtretërve të përrenjve në Komunën e Rahovecit" e cila kap vlerën 815 988 10 eurove. Me këtë rast, Latifi ka thënë se do të angazhohet që të punojë për të mirën e të gjithëve. "Pas përfundimit të të gjitha procedurave, në mënyrë transparente, sot kam nënshkruar kontratën për realizimin e projektit 'Trajtimi i shtretërve të përren-

jve në Komunën e Rahovecit', në vlerën: 815 988 10 euro. Në grantin e performancës që ka fituar Komuna e Rahovecit ka ndarë buxhet për trajtimin e shtretërve të përrenjve në komunën tonë, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, sipas kësaj kontrate, do t'i realizojë projektet e trajtimit të përrenjve në këta fshatra: Opterushë, Pataqan i Ulët, Malësi e Vogël dhe Polluzhë. Do të angazhohemi edhe më tutje të punojmë për të mirën e të gjithëve, pa dallim!", ka thënë Latifi.



Rregullohet ndriçimi në fshatin Bardh i Malishevës

MALISHEVË, 2 SHTATOR (ER) - Në kuadër të rregullimit të ndriçimit publik në fshatrat e Komunës së Malishevës, ka përfunduar rregullimi i ndriçimit publik në fshatin Bardh. Në lëshimin në funksion të ndriçimit publik në këtë fshat ishte i pranishëm edhe drejtori i Urbanizmit, Ahmet Morina, i shoqëruar edhe nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, Valon Krasniqi dhe Astrit Sertolli. "Jemi në

fazën e rregullimit të ndriçimit publik në të gjitha fshatrat, në të cilat kuvendi i komunës ka paraparë të rregullohet ndriçimi dhe gradualisht jemi duke e përmbyllur këtë projekt. Mbrëmë kemi përfunduar me fshatin Bardh, ku është rregulluar ndriçimi i paraparë dhe ajo që vlen të theksohet është edhe bashkëpunimi i mirë me banorët e fshatit, të cilët kanë participuar për sigurimin e

shtyllave në rrugët ku nuk ka pasur shtylla për vendosjen e dritave. Banorët i kanë siguruar dhjetë shtylla dhe ky është një shembull i bashkëpunimit të mirë me banorët për realizimin e projekteve, pasi shtyllat nuk kanë qenë të parapara në projekt, por vetëm vendosja e dritave dhe rrymës në shtyllat ekzistuese", ka thënë drejtori Morina, i cili i ka uruar banorët për rregullimin e ndriçimit.



ÇFARË FSHIHET PRAPA KËRKESËS GREKE PËR NDRYSHIMIN E TEKSTEVE NË LIBRAT E GJEOGRAFISË DHE TË HISTORISË SHQIPTARE?



Nga Jakup KRASNIQI

Siç informuan mediat në gjuhën shqipe, eurodeputeti grek i "Demokracisë së Re", Manolis Kefalogiannis, ka

ngritur në Komisionin Evropian çështjen e ndryshimit të teksteve në librat e gjeografisë dhe të historisë shqiptare, me qëllim që as në Shqipëri të mos figurojë asgjë lidhur me Çamërinë dhe shqiptarët e Çamërisë.

Dihet fare mirë se në të gjitha periudhat e krimit të gjenocidit ata që kanë kryer krim të shëmtuar vënë në përdorim të gjitha strategjitë e mundshme për ta fshehur

gjenocidin e kryer kundër një grupi kombëtar, etnik, racor ose fetar, si të tillë. Prandaj, krahas heshtjes së plotë në planin e brendshëm, përfaqësuesit e shtetit grek, edhe të institucioneve të saj politike, përpiqen ta imponojnë interpretimin e tyre edhe jashtë kufijve të shtetit të tyre. Madje një gjë të tillë përpiqen ta paraqesin si qëndrim të institucioneve të BE-së se gjoja "kjo kërkesë themelore do t'i forconte

marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe të siguronte që fëmijët dhe të rinjtë shqiptarë të mos keqinformohen".

Në përputhje me Konventën për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit dhe me Statutin e Romës, vrasja, dhuna seksuale dhe dëbimi masiv i shqiptarëve në Çamëri që kishte për qëllim të shkatërronte shqiptarët si të tillë që jetonin në trojet e tyre është gjenocid që ka kryer shteti grek.

Jo fshehja e krimit të gjenocidit, por njohja e të vërtetës së plotë për gjenocidin në Çamëri dhe riparimi i atyre dëmeve që mund të riparohen, do t'i forconte marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe do të siguronte që fëmijët dhe të rinjtë shqiptarë dhe grekë të mos keqinformohen.

Për këtë arsye, Greqia duhet t'i ndryshojë tekstet e librave të gjeografisë dhe të historisë lidhur me çështjen çame!

HOVI I HEGJEMONIZMIT SERB



Nga: Lëvizja VETËVENDOSJE

Me flamuj të Serbisë, me thirrje raciste antishqiptare, me parulla kundër Kosovës e për Rusinë, me liturgji politike të Amfilohije Radoviqit në funksion të shovinizmit, Mali i Zi ndodhet para ndryshimeve të mëdha si pasojë e zgjedhjeve të së dielës, fushata për të cilat ishte shumë më e gjatë sesa ajo zyrtare dhe shumë më e gjerë sesa vetëm në Mal të Zi.

Tri parti opozitare pritet të formojnë koalicionin e ri qeverisës me kabinet ekspertësh. Partia më e madhe aty "Frontit Demokratik" dhe ajo e dyta "Paqja është kombi ynë" janë pro-serbe. Kreu i "Frontit Demokratik" as vetë nuk e kishte pritur rezultatin e lartë

prej 32,5%, duke konfirmuar kështu se kjo fitore nuk ishte njëmend e tyre, dhe se në fakt, janë Kisha Ortodokse Serbe dhe Beogradi ato që u përfshinë në garë.

Në Ballkan tashmë ndodhet Kaliningradi rus, në Republikën Serbe të Bosnje Hercegovinës. Nuk kemi nevojë për Kaliningradë të rinj. Nëse arrijnë ta formojnë qeverinë këto tri parti, atëherë bashkëjetesa ndëretnike në Mal të Zi, edhe ashtu e brishtë, do të pamundësohet dhe shqiptarët duhet të mendojnë për orientime të reja.

Që nga zgjedhjet e fundit të mbajtura para dy muajve, 3/4 e Kuvendit të Serbisë është në duart e Vuçiqit. Presidenti, kryeministri dhe kryetari i Kuvendit atje janë nga e njëjta parti politike. Serbia nuk është

shtet demokratik. Homogjenizimi nacional i elektoratit serb është fort i ngjashëm me atë nga fundi i viteve '80. Ky homogjenizim me pushtet autoritar, frymë religjioze dhe përmbajtje ultra-konservatore po përkthehet në hegjemonizëm rajonal.

Federata Ruse është përcaktuar për serbët si satelit të saj në Ballkan, andaj situata politike ngjan më shumë si ajo në prag të Luftës së Parë Ballkanike sesa si ajo pas Paqes së Shën Stefanit. NATO-ja dhe BE-ja nuk bën t'i ngjajnë Perandorisë Osmane në dekadën e saj të fundit. Ato nuk guxojnë të mjaftohen me paqen dhe sigurinë në Maqedoninë e Veriut, duke e reduktuar aty krejt paqen dhe sigurinë rajonale.

Shqiptarët duhet të faktorizohen për ta balancuar

Serbinë. Nuk mund të ecim në shekullin XXI me këto shtetet tona të dobëta që udhëhiqen nga politikanë karagjozë e të korruptuar. Ata nuk gëzojnë autoritet dhe besim te shqiptarët, andaj ishte e kotë, në mos kundër-produktive, thirrja e tyre e përsëritur për të votuar në Mal të Zi njërin koalicion shqiptar. Kosova e Shqipëria duhet ta bëjnë bashkimin ekonomik dhe ta unifikojnë politikën e jashtme e të sigurisë, dhe jo të vrapojnë pas Vuçiqit për Mini-Schengen Ballkanik apo për njohje me 'Zajednicë'. Në fillim të shekullit XX, Rusia cariste synonte një Aleancë Ballkanike kundër perandorive Austro-hungareze dhe Osmane. Këto dy perandori nuk ekzistojnë më. Shqiptarët atëbotë bënë më së shumti rezistencë dhe organizuan më

së shumti kryengritje por ngelën me një shtet që nuk përthekonte as një të tretën e trojeve të cilat asokohe banoheshin prej kombit tonë. Një shekull më vonë, e në prag të dekadës së tretë të shekullit XXI, na nevojitet një Aleancë Ballkanike, por kësaj radhe përballë hegjemonizmit të Serbisë dhe imperializmit të Rosisë.

Ne shqiptarët jemi në qendër. Në njërin krah kemi kroatët e në tjetrin bullgarët. Bashkë me ta, por edhe me Sarajevën, Podgoricën dhe Shkupin zyrtar, mund e duhet ta krijojmë Aleancën 3+3, që të ruajmë paqen, të fitojmë Evropën e të forcojmë NATO-n, që të mos e harrojmë shekullin e kaluar e që të mos gabojmë në këtë shekull, pa inat ndaj të tjerëve e për hir të vetes tonë.


Gjendet i vdekur në shtëpi DJ krijues i kolonës zanore të “Madagascar”-it



Dj Erick Morillo, i njohur për këngën hit të vitit 1993, “I Like To Move it”, është gjetur i vdekur në Florida. Trupi i 49-vjeçarit u gjet mëngjesin e së mërkurës në një shtëpi në Miami sipas policisë. Vdekja e tij është nën hetim. Më 6 gusht Morillo u arrestua me akuzën e ngacmimit dhe abuzimit seksual ndaj një DJ femër, me të cilin kishte luajtur në një festë private në dhjetor të

2019-s. Ajo kishte shkuar në shtëpinë e tij në Miami, bashkë me një tjetër vajzë dhe pretendon se Morillo e kishte ngacmuar dhe ishte përpjekur të abuzonte me të, edhe pse ajo kishte refuzuar. Pasi u bë publik lajmi për vdekjen e tij, të shumtë kanë qenë ata të cilët kanë shprehur mesazhet e ngushëllimit në rrjetet sociale, përfshirë këtu Dj e njohur si Dj Pauly D apo Dj Yousef.

Beyonce i dërgon Katy Perryt dhuratën më të bukur për vajzën



Beyonce e ka uruar Katy Perryt që u bë nënë për herë të parë, duke sjellë në jetë një vajzë të quajtur Daisy dove, shkruan “Elle”. Të martën këngëtarja 35-vjeçare ndau fotot e dhuratave që ka marrë nga dashamirët, duke përfshirë një dhuratë befasuese nga Beyonce.

Nëna e tre fëmijëve i dërgoi Perryt një buqetë me lule të bardha dhe një kartë me një mesazh ku shkruhej: “Urime për anëtarin e ri në familjen tuaj! - Beyonce”. Duke falënderuar këngëtarën për dhuratën, Perry shkroi “Të dua, Beyonce”.



Beatrix Ramosaj mahnit me linjat

Bukuroshja e njohur Beatrix Ramosaj është një personazh mjaft i ndjekur në rrjetet sociale. Shpesh ajo ndan me ndjekësit fotografi dhe video të ndryshme nga përditshmëria, në të shumtën e rasteve edhe imazhe ngacmuese. Së fundmi, Beatrix publikoi në rrjetet sociale për fansat disa fotografi nga pushimet, ku shfaqej mjaft tërheqëse në disa poza me bikini të kuqe. Ajo ka pozuar mjaft tërheqëse në kuvertën e një jahti, teksa ka vënë në pah linjat atraktive. Pëlqimet dhe komentet nga ndjekësit e saj kanë qenë të shumta, shumica prej të cilëve e kanë përgëzuar bukuroshen për fizikun e saj.



Bim Bimma publikon këngën “Ftyrat”



Bim Bimma po mendon për fansat edhe gjatë kësaj periudhe pandemie, andaj ka publikuar një projekt të ri. Bëhet fjalë për këngën me titull “Ftyrat”, të cilën fillimisht e solli vetëm në platformën “Spotify”. Por, përmes një

tjetër postimi në rrjetet sociale, Bimma njoftoi fansat se këtë këngë do ta sjellë të shoqëruar edhe me videoklip, i cili do të publikohet të premten. Kujtojmë se Bim Bimma javët e fundit është diskutuar për një ‘sherr’ virtual me reperin Fero.






ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Kosova synon ta nisë edicionin me fitore

Sonte (e enjte) Kosova e fillon edicionin e ri në Ligën e Kombeve. Ajo do të përballet me Moldavinë në Itali. Synimi i "dardanëve" është që ta fitojnë ndeshjen e parë, e cila fillon në orën 20:45. Kosova pas tri ditësh përballet edhe me Greqinë në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll të martën në mbrëmje në stadiumin "Fadil Vokrri" e ka mbajtur stërvitjen e fundit në Kosovë, kurse të mërkurën paradite ka pranuar rezultatet e bëra për Covid-19. Lajmi i mirë ishte se e gjithë ekspedita e "dardanëve" ka rezultuar negativ, ku më pas Përfaqësuesja ka udhëtuar drejt Italisë, kurse të mërkurën në Parma, Kosova e zhvilloi ndeshjen.

Sot (e enjte), Kosova, e drejtuar nga përzgjedhësi Bernard Challandes, e zhvillon ndeshjen e parë të edicionit të ri të Ligës së Kombeve në kuadër të grupit 3 të Ligës C kundër Moldavisë. Trajneri zviceran në stërvitjen e fundit punoi në lojën në hapësira të ngushta dhe në lojën sulmuese, por edhe në skema të ndryshme taktike. Mesfushori Anel Rashkaj, që ishte në listën

rezervë dhe u ftua pas problemeve për grumbullimin e lojtarëve, ka thënë se futbollistët do ta japin maksimumin për të marrë rezultat pozitiv. Ai e ka pranuar se kjo situatë nuk është aspak e lehtë, por ndihet i lumtur që sërish është pjesë e "dardanëve". "Ka kaluar një kohë e gjatë që nuk jemi mbledhur në Përfaqësuesë shkaku i pandemisë. Është kënaqësi që jemi mbledhur prapë me lojtarët dhe trajnerët. Është një situatë e vështirë jo vetëm për ne, por për të gjitha kombëtaret në futboll. Kemi probleme me klube që nuk na lejojnë lojtarët", ka deklaruar Rashkaj. "Në këtë situatë që jemi do ta bëjmë maksimumin dhe presim të paraqitemi sa më mirë, së pari të koncentrohemi në ndeshjen me Moldavinë, pastaj për ndeshjen këtu në Prishtinë kundër Greqisë. Shpresoj të japim maksimumin dhe ta marrim rezultatit pozitiv", ka shtuar Rashkaj. Ndërsa trajneri Bernard Challandes i sheh dy ndeshjet e

shtatorit si përgatitje për ndeshjen gjysmëfinale ndaj Maqedonisë së Veriut. Ai ka thënë se Kosova ka bërë përparim në Ligën e Kombeve dhe se lojtarët duhet ta rinisin përparimin e tyre për ekipin përfaqësues. "Situata nuk është e lehtë dhe nuk është e tillë vetëm për ne. Kemi lojtarë të kampionateve të ndryshme për të cilët nuk do të jetë e lehtë. Duhet të adaptohen. Sa i përket Ligës së Kombeve, nuk është e njëjtë si ajo para Evropianit. Qëllimi ynë është që të rritemi përmes Ligës së Kombeve dhe këto ndeshje do të jenë përgatitje për barazhin me Maqedoninë e Veriut. Ne kemi bërë përparim në këtë ligë dhe unë do të kërkoj nga lojtarët që ta rrisim përparimin edhe ndaj këtyre kombëtareve. Lojtarët duhet të japin më të mirën për kombëtaren", ka deklaruar Challandes. Ndeshja në mes të Moldavisë dhe Kosovës zhvillohet sonte nga ora 20:45.

SHKURT

Gabanas: Objektivi kryesor është kualifikimi

Trajneri spanjoll i Besa Famgas, Javier Cabanas, ka vlerësuar se Bosna Vispako është kundërshtar i kalueshëm. Besa takohet me Bosnan në raundin e dytë të Kupës Evropiane. "Nuk di shumë gjëra për Bosna Visokon në këtë kohë. Është ekipi i tretë në Bosnjë dhe mendoj se kemi shanse të fitojmë këto ndeshje eliminatorë. Mendoj se ka pasur ekipe më të vështira të mundshme në short. Ndeshjen e dytë do ta luajmë në shtëpi dhe kjo është mirë për ne. Objektivi ynë kryesor është t'i fitojmë eliminatorët dhe të luajmë në raundin e tretë. Në ditët e ardhshme do të kemi më shumë informata për kundërshtarin", ka thënë Cabanas.

Kabashi: Ishim me fat në short

Taib Kabashi ka thënë se Prishtina ishte me fat në shortin për Kupën Evropiane, pasi përballet me skuadrën bullgare Dobrudja. "Ishim me fat në short. Besoj se do ta kalojmë raundin e dytë, do ta mposhtim ekipin bullgar Dobrudja. Por, shpresoj të fillojmë përgatitjet sa më shpejt. Presim nga Ministria e Sportit leje. Ekipi Dobrudja rregullisht merr pjesë në gara evropiane, por nuk ka rezultate për t'u veçuar. Ne e kemi ekipin e mirë që do të përforcohet edhe me disa lojtarë vendorë. Por së pari do të hartojmë një plan me kryetarin Edi Kolgeci dhe kryesinë, për Superligë dhe gara evropiane. Duhet të përgatitemi sa më mirë për sfidat që na presin në këtë kohë pandemie", ka thënë Kabashi.

Parduzi: Synimet janë për rezultate pozitive

Trajneri i Vushtrrisë, Arben Parduzi, nuk është befasuar me shortin për Kupën Evropiane. Shorti ka bërë që fituesja e Kupës, Vushtrria, të përballet me Istogun, finalistin e plejofit. "Duke pasur parasysh rrethanat e krijuara nga Covid-19 në gjithë botën, kemi pritur të përballemi me ekipet e rajonit, por nuk e kemi përjashtuar mundësinë që të përballemi me ekipin e Istogut pasi ishim në zonë të njëjtë e vazo të ndryshme. Fatimi deshi që të takohemi mes vete. Synimet e Vushtrrisë gjithmonë janë për rezultate pozitive, andaj ne do të përgatitemi sa më mirë për këto përballje jo të lehta në këtë kohë të cilën po e kalojmë, me kushte të kufizuara në lëvizje e, po ashtu, me palestra të mbyllura. Por shpresojmë të na mundësojnë që ekipet që jemi në gara ndërkombëtare të zhvillojmë stërvitjen në palestra. Është hera e parë që dy ekipe të Kosovës takohen mes vete në gara ndërkombëtare, andaj do të jenë dy lojë interesante dhe të forta. Do të shohim mundësitë që kemi që të përforcohemi për këto dy ndeshje, në pozitë ku kemi nevojë më shumë", ka thënë Parduzi.

Shala: Pozitive përballja e dy klubeve të Kosovës në Kupën Evropiane

Trajneri i Istogut, Faruk Shala, vlerëson se shorti për Kupën Evropiane është i përshtatshëm si për Istogun ashtu edhe për Vushtrrinë. Një prej këtyre dy skuadrave do të kalojë në raundin e tretë të Kupës Evropiane. "Shorti është i favorshëm për të dy skuadrat ngaqë eliminon mundësinë e shfaqjes së problemeve si pasojë e pandemisë Covid-19 si në rastin e skuadrave të futbollit. Mundëson organizim më të lehtë të ndeshjeve, zvogëlon koston e shpenzimeve, që është shumë e rëndësishme në këtë kohë, kur gjendja financiare e klubeve është e rënduar si pasojë e pandemisë. Vushtrria është favorite pasi ka qenë më e suksesshme se në këtë vit. Për këtë edhe ka qenë në vazon e parë. Por ne i kemi synimet tona që ta kalojmë këtë fazë ashtu si rivali ynë. Shpresojmë që t'ia arrijmë", ka thënë Shala. "Ballafaqimi i dy skuadrave të Kosovës është i mirë për hendbollin e Kosovës sepse tani dihet që në raundin e tretë do t'i kemi dy skuadra tonat. Është për t'u përshëndetur që dy skuadra nga Kosova do të jenë në raundin e tretë. Ndeshja ndaj Vushtrrisë, sipas të gjitha gjasave, do të zhvillohet në Istog, ashtu si janë zotuar udhëheqësit e MKRS-së dhe Komunës së Istogut", ka shtuar Shala.

Fundjava me çiklizëm në Ferizaj

FERIZAJ, 2 SHTATOR - Në fundjavë, më 5-6 shtator, do të mbahet gara e shumëpritur e Kampionatit të Kosovës në çiklizëm. Çiklistët më të mirë të klubeve për dy ditë do të sjellin në qytetin e Ferizajt adrenalinën e munguar tash e sa kohë të

këtyre aktiviteteve shkak i pandemisë. Pas insistimit të Federatës së Çiklizmit të Kosovës, më në fund është arritur marrëveshja që Kampionati i Kosovës të zhvillohet. Të shtunën, me fillim nga ora 11:00, do të mbahet gara e kronometrit,

në relacionin Ferizaj - Babush i Muhaxherëve - Ferizaj. Të dielën, nga ora 11:00, mbahet etapa e gjatë 125 km dhe zhvillohet në autostradë, në relacionin Ferizaj-Doganaj-Mazgit-Hani i Elezit. "Federata e Çiklizmit e Kosovës lutë të

gjithë qytetarët që në këto intervale ta evitojnë qarkullimin nëpër rrugët e lartëcekura, duke kërkuar mirëkuptimin e tyre dhe bashkëpunimin për një organizim sa më të mirë", thuhet në njoftimin e FÇK-së.



Shatri: Jemi i vetmi shtet në Evropë me palestra të mbyllura

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Klubi i Basketbollit Prishtina në konkurrencën e femrave nuk po qëndron duarkryq para kampionatit të ri të basketbollit 2020/2021. "KosovaHome" është sponsori i ri, kurse ka vazhduar kontratat me disa nga lojtaret e edicionit të kaluar, si dhe ka rikthyer Gentiana Ismailin, derisa është përforcuar edhe me basketbollisten nga Shqipëria Elektra Zykaj. Gjithashtu skuadra prishtinase ka paralajmëruar përforsime të tjera.

Trajneri Fidan Shatri ka folur rreth përgatitjeve për edicionin e ri, duke qenë shumë aktiv, edhe pse vendi po përballet me pandeminë Covid-19. "Që shumë kohë jemi duke u marrë me organizim të skuadrës dhe jemi duke e kompletuar skuadrën për sezonin e ri. Natyrisht se situata me Covid-19 na ka ndërprerë edhe planin që kemi pasur që gjatë verës të punojmë me gjenerata të reja, pra me lojtare që janë e ardhmja e basketbollit të femrave. Fokusi kryesor do të jetë ngritja e cilësisë së lojtareve që janë më të reja, si dhe hap pas hapi ta krijojmë filozofinë e lojës me prurjet e reja", është shprehur Shatri për faqen zyrtare të FBK-së.



Ai ka paralajmëruar të tjera përforsime, por shpreson se do ta marrin dritën e gjelbër për lejimin e stërvitjeve. "Kemi vazhduar me disa lojtare kontratat që kanë qenë pjesë vitin e kaluar, me disa jemi në bisedime dhe një apo dy lojtare do të jenë prurje që nuk kanë qenë më herët pjesë e skuadrës. Gjithashtu, pjesë e skuadrës do të jenë edhe dy lojtare që janë të reja në moshë, që janë e ardhmja e basketbollit në vendin tonë, pasi që me vite u kemi dhënë hapësirë dhe mendoj se jemi në drejtim të duhur. Shpresoj që shumë shpejt

Qeveria e Kosovës do t'i hapë palestrat, pasi që jemi i vetmi shtet në Ballkan dhe Evropë që nuk jemi duke punuar. Falënderoj sponsorin 'KosovaHome' për mbështetjen që po i jep klubit dhe besoj që së bashku do të bëhet punë e mirë për ngritje të nivelit të basketbollit të femrave", ka shtuar Shatri.

Skuadra e Prishtinës edicionin e kaluar për herë të parë mori pjesë në FIBA Eurocup Women që, gjithashtu, ishte hera e parë për një skuadër nga Kosova pjesëmarrëse në këtë garë.

Kualifikohet Denveri, Bostoni mposhti sërish Toronton



ORLANDO, 2 SHTATOR - Denver Nuggets ishte skuadra e radhës që siguroi një biletë për në fazën çerekfinale të "play-off"-it dhe për në gjysmëfinale të konferencës së Perëndimit. Skuadra nga Colorado triumfoi në përballjen e 7-të ndaj Utah Jazzit me rezultatin e ngushtë 80-78, duke siguruar kualifikimin 4-3 me ndeshje. Më i miri mbi parket për Denverin

ishte Nikola Jokiq me 30 pikë, 14 rebounde dhe 4 asistime. Në fazën tjetër Denveri do të ketë përballë Los Angeles Clippersin. Ndërkohë në ndeshjen tjetër të mbrëmjes, atë për fazën çerekfinale mes Boston Celticsit dhe Toronto Raptorsit, arriti të triumfojë sërish Bostoni me rezultatin 102-99, falë edhe 34 pikëve të shënuara nga Jason Tatum.

Conte e dëshiron në Inter, por Kanten e 'tradhton' Chelsea

Mesfushori i Chelseas, Ngolo Kante, është përfolur ditët e fundit për kalim në radhët e Interit. Edhe pse në kampin zikaltër kampioni i botës do të gjente Antonio Conten, me të cilën fitoi edhe Premierë Ligën, ai sërish dëshiron të qëndrojë në Londër. Sipas raportimeve të mediave angleze,

29-vjeçari kërkon ta vazhdojë aventurën te Chelsea edhe pse në sezonin e fundit ai u aktivizua në 50 % të ndeshjeve nga trajneri Lampard. Sezioni i kaluar nuk ishte më i miri për Kanten në "Stamford Bridge", pasi gati për gjatë gjithë sezonit dëmtimet nuk e lanë të qetë. Ndërkohë, nga ana

tjetër, Interi po përgatit një ofertë për mesfushorin e cila me shumë mundësi do të refuzohet si nga lojtari, por edhe nga klubi ishullor. Trajneri Lampard në fundin e sezonit deklaroi se Kante është një lojtar shumë i rëndësishëm për ekipin dhe kurrsesi nuk do ta dëshironte largimin e tij.

SHKURT

FShF-ja mohon lajmin se tre futbollistë kanë rezultuar pozitivë me Covid-19

Federata e Futbollit të Shqipërisë (FShF) ka mohuar lajmin se tre futbollistë të Kombëtares së Shqipërisë kanë rezultuar pozitivë me Covid-19. Në disa medime në Shqipëri është raportuar se Ardian Ismajli, Ylber Ramadani dhe Hysen Memolla kanë dalë pozitivë me Covid-19. "Federata Shqiptare e Futbollit përgënjeshtroi lajmin e rremë të shpërndarë nga tri media, se tre futbollistë të kombëtares shqiptare kanë rezultuar pozitivë në testin për Covid. Ky lajm është i pavërtetë dhe tendencioz. Asnjë lojtar i kombëtares, pjesëtar i stafit apo anëtar i delegacionit nuk ka rezultuar pozitiv. Bashkëngjitur edhe testet e futbollistëve të përmendur. I bëjmë thirrje medias të distancohet nga këto lajme të pavërteta dhe nga kjo praktikë aspak profesionale", është thënë në demantin e FShF-së.

Volland prezantohet te Monaco

Kevin Volland është transferuar edhe zytraishtë në Monaco. Sulmuesi gjerman për katër vjet ishte pjesë e skuadrës së Bayer Leverkusenit, me të cilin zhvilloi 148 ndeshje, duke shënuar 50 gola. 28-vjeçari i cili u kushtoi francezëve 15 milionë euro firmosi një kontratë deri në vitin 2024 me skuadrën e drejtuar nga Niko Kovaç. Largimi i Vollandit i hap dyert e Leverkusenit sulmuesit çek Patrik Schik i cili sezonin e fundit u aktivizua në formë huazimi te Leipzig.

Interi nuk është në garë për transferimin e Messit

Leo Messi mund të largohet nga Barcelona, por skuadra e Interit nuk është në garë për transferimin e tij. Lajmin e ka konfirmuar drejtori sportiv i Interit, Piero Ausilio. "Nuk ka asgjë për Messin. Nuk e di se nga vjen kjo ide. Nuk ka ndonjë klub në futboll që nuk do ta donte Messin. Por aty është realiteti i fakteve", ka thënë Ausilio. Tri skuadrat që janë të interesuara për yllin argjentinas janë Manchester City, Paris Saint-Germain dhe Juventusi.

Hamilton: Nuk kam rivalë, kampionati është i mërzitshëm

Fuqia e padiskutueshme e Mercedesit në garë dhe fakti se pas shtatë garash ka 47 pikë avantazh me rivalët ka bërë që Lewis Hamiltoni të pranojë se ky sezon i Formula 1 është shumë i mërzitshëm. Piloti britanik ka fituar deri më tani 5 gara, duke qenë lider i padiskutueshëm. "Unë jam një pilot që bëj pak gabime. Edhe të tjerët, po ashtu. Në shumë pista është e vështirë të parakalohet, ndaj garat bëhen të mërzitshme për ne që jemi në pistë dhe për tifozët që e shohin nga ekran. Unë shpresoj që në garat e tjera të duelojmë me shumë me Bottas e Verstappen", ka thënë Hamiltoni. "Shpresoj që tifozët ta kuptojnë se nuk është faji ynë, as i makinave. Duhet ndryshuar shumë gjëra në këtë sport që të ketë më shumë rivalitet në pistë. Shpresoj që nga viti 2022 ky sport të jetë më tërheqës për të gjithë. Uroj që të mos shohim më gara të tilla si këtë vit", ka deklaruar Hamiltoni.



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVISIONI I KOSOVO
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

shpall: K O N K U R S

Për plotësimin e këtyre vendeve të lira të punës në RTK - TV

Gazetar 2 (nr. 1027)

4 pozita

Detyrat

- Shkruan dhe përgatit lajmet për transmetim;
- Prodhon kronika, duke shfrytëzuar teknikën prodhuese përkatëse;
- Është përgjegjës për burimin e informacionit dhe zhvillimin e kronikës;
- Kontribuon në planifikimin dhe në mbulimin e ngjarjeve;
- Përzgjedh materiale relevante për transmetim;
- Rishkruan dhe korrigjon lajmet sipas kërkesës së eprorit;
- Zhvillon intervista në studio dhe në lokacione të tjera në bazë të kërkesës së eprorit;
- Grumbullon njohuri të specializuara sipas nevojës;
- Mban kontakte të rregullta me palë për të siguruar informata të nevojshme për lajme;
- Prodhon, monton dhe dërgon lajme me teknologji të re smart;

Kushtet

- Kualifikimi superior profesional; Së paku gjashtë muaj përvojë pune në punë të ngjashme;
- Kultivimi i një standardi të lartë të gjuhës amtare në të shkruar dhe në të folur;
- Njohuri e punës në kompjuter;
- Njohuri e shkëlqyeshme e gjuhës angleze në të folur dhe në të shkruar;
- Njohje e procesit të montimit dhe njohje e punës për kamerë;
- Aftësi për të punuar me ndërrime dhe me orar të zgjatur;
- Aftësi për të punuar qetë nën presion dhe si pjesë e ekipit;
- Përkushtimi ndaj shërbimit publik informativ;
- Ndershmëria, kreativiteti dhe aftësia për të punuar me vetëiniciativë;

Producent i emisionit (nr. 1022)

1 pozitë

Detyrat

- Koncepton dhe realizon emisionin në koordinim me eprorin e tij;
- Mbikëqyr dhe përkujdeset për mbarëvajtjen e emisionit gjatë transmetimit;
- Koordinon punën e ekipit në realizimin e emisionit;
- Bart përgjegjësi për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm;
- Koordinohet me eprorët dhe skemën programore për transmetime;
- Mban raporte të rregullta për emisionet dhe pjesëmarrësit;
- Mbikëqyr dhe përkujdeset për hartimin strategjive efektive për freskim dhe ngritje të cilësisë së emisionit;
- Përkujdeset për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë së emisionit;
- Mbikëqyr dhe merr pjesë aktive si në planifikimin afatshkurtër ashtu edhe atë afatgjatë të programit.

Kushtet

- Kualifikimi superior profesional;
- Së paku një vit përvojë pune;
- Të kultivon standardin e lartë të gjuhës amtare në të folur dhe në të shkruar;
- Të ketë njohuri pune në kompjuter;
- Të ketë njohuri të gjuhës angleze;
- Të ketë aftësi të dëshmuara në organizim, udhëheqje dhe planifikim;
- Aftësi për të punuar qetë nën presion dhe si pjesë e ekipit;
- Njohje dhe interesim lidhur me programin e përgjithshëm të RTK-së;
- Përkushtimi ndaj shërbimit publik informativ;
- Ndershmëria, kreativiteti dhe aftësia për të punuar me vetëiniciativë;

Montazher 2 (nr. 1517)

2 pozita

Detyrat

- Operon me montazhat lineare dhe jo-lineare (kompjuterike);
- Duhet të jetë kreativ në prodhimin e të gjitha llojeve të programeve;
- Video materiali i montuar ose i përpunuar (post-produksion) duhet t'i plotësojë të gjitha standardet profesionale në aspektin teknik dhe artistik;
- Bashkëpunon ngusht me regjisorin (realizatorin), producentin ose autorin e emisionit përkatës; Ndërmerr masa për mirëmbajtje në kohë të pajisjeve.

Kushtet

- Kualifikim të mesëm profesional;
- Së paku gjashtë muaj përvojë pune në punë të ngjashme;
- Njohuri e punës në kompjuter;
- Njohja e programeve aplikative për montazhet jolineare;
- Njohuri e gjuhës angleze në të folur dhe në të shkruar;
- Aftësi për të punuar me ndërrime dhe me orar të zgjatur;
- Aftësi për të punuar qetë nën presion dhe si pjesë e ekipit;
- Përkushtimi ndaj shërbimit publik informativ;
- Ndershmëria, kreativiteti dhe aftësia për të punuar me vetëiniciativë;

Montues i pajisjeve teknike (nr. 1501)

1 pozitë

Detyrat

- Monton pajisje teknike në studio dhe terren;
